



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1176/ Prot.
27

Tiranë më 04.5.2023

VENDIM

Nr. 29, datë 04.05 2023

“Për miratimin e ndryshimeve deri në masën 20%, të planeve mësimore të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, të UT-së, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma “b”; neni 35, pika 9; neni 38, pika 1, gërma “dh”; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 31, gërma f; si dhe në propozimin e përcjellë nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës me shkresat nr. 64/9 prot., datë 09.03.2023, nr. 64/19 prot., datë 25.04.2023 dhe nr. 64/21 prot., datë 02.05.2023, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 04.05.2023;

VENDOSI:

- Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës për ndryshime deri në masën 20% në planet mësimore të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, për vitin akademik 2023-2024, në:
 - “Bachelor” në “Biologji”;
 - “Bachelor” në “Bioteknologji”;
 - “Bachelor” në “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”;
 - “Bachelor” në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”;
 - “Master i Shkencave” në “Biologji Mjedisore”;
 - “Master i Shkencave” në “Biologji Molekulare”;
 - “Master i Shkencave” në “Kimi Industriale dhe Mjedisore”;
 - “Master i Shkencave” në “Shkencat dhe Teknologjitë Ushqimore”;
 - “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Biologji për Arsimin e Mesëm të Lartë”;
 - “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Matematikë për Arsimin e Mesëm të Lartë”;
 - “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”;
 - “Master i Shkencave” në “Matematikë”.
- Ky vendim i përcillet për njoftim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha